



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 6543 Prot.

Tiranë, më 7.12.2020

UDHËZIM

Nr. 26, datë 7.12. 2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 03.08.2016 "PËR
PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE
TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT
TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT", I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të 91 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në pikën 5,4, të Kreut IV të Udhëzimit Nr. 17, datë 03.08.2016, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

"5.4 Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsim, komisione "ad hoc" sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës të kategorisë "profesor", i cili mblidhet në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrton dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është ministri përgjegjës për arsimin. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 30 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit komisioni firmos procesverbalin dhe ministri përgjegjës për arsimin lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik."

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet "ad hoc".

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR
EVIS KUSHI

